



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Shërbimi Procedurë e hapur

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

Data e shpalljes: 24.07.2025

Nr. i Prokurimit: "BQK 25 052 221"

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK	
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: +383 38 222 055/451	

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Shërbime të testimit dhe vlerësimit të sigurisë së sistemeve IT (dy pjese/lotë)"
Lloji i prokurimit: Kontratë shërbimi
Vendi kryesor i realizimit: Prishtinë
Informacione të marrëveshje afatgjatë: Kontrate me afat 2 (dy) vjeçar
Variantet pranohen: Jo
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur e ndarë në pjesë/lot
Vlera e parashikuar e kontratës:
Vlera e parashikuar e kontratës:

LOT 1: 60,000.00 Euro. LOT 2: 20,000.00 Euro
Ndarja në Pjesë (lote): PO Lot 1- Shërbimi për realizimin e testeve të sigurisë së sistemeve të informacionit. Lot 2-Shërbimi për Vlerësimin e Sigurisë së Sistemit të SWIFT-it.

III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale shërbimet e kërkuara , sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t’u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESEMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t’i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim. **Vëmendje për operatorët ekonomik që t’i kenë parasysh kërkesat sipas tabelës në vijim rreth vendosjes së evidencave/dëshmive në ofertat e tyre.**

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 kur aplikohet) janë të obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas</i>	<u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë. <u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin përkatës i cili gjendet në dosjen e tenderit.
	<u>Kërkesa 2:</u> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C. <u>Evidenca 2:</u> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në Kërkesat 1, 2 dhe 3 të kësaj tablele.

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

<p><i>dorëzimit të ofertës!</i></p>	<p><u>Kërkesa 3:</u> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p> <p><u>Evidenca 3:</u> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohet si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.</p> <p>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të Rregullës për Prokurimin në BQK. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshatshmërinë e profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Evidenca 4:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Kërkesa 5:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><u>Evidenca 5:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><u>Kërkesa 6:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><u>Evidenca 6:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>

	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6 të kësaj tablele.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 7, 8, 9, 10 dhe 11) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime	<p><u>Kërkesa 7: Për Lotin 1-</u> Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar në mënyrë profesionale së paku tri kontrata të ngjashme me Banka Qendrorë ose Banka Komerciale përgjatë 5 (pesë) viteve të fundit (2020 2021, 2022, 2023, 2024 përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate).</p> <p><u>Për Lotin 2-</u>Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku tri kontrata të ngjashme, me Banka Qendrore ose Banka Komerciale përgjatë 5 (pesë) viteve të fundit (2020 2021, 2022, 2023, 2024 përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate).</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Ofertuesi duhet të ofroj si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat relevante të pranimit të shërbimit ose referencat që evidentojnë realizimin e shërbimit të tillë, dhe</p> <p>b) kopjet e kontratave përkatëse</p> <p><u>Kërkesa 8.</u> Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><u>Evidenca 8.</u> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me shërbimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve;</p> <p><u>Kërkesa 9: (Vetem për Lot 1):</u> Në ekip, ofertuesi duhet të ketë të paktën 3 anëtarë të stafit të certifikuar me certifikata të rëndësishme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • PNPT (Practical Network Penetration Tester) • OSCP (Offensive Security Certified Professional) • OSCE (Offensive Security Certified Expert) <p><u>Evidenca 9:</u> Kopje të certifikatave të stafit të deklaruar</p> <p><u>Kërkesa 10:</u> Ekspertiza e ekipit:</p> <p><u>Për lot 1:</u> Ofertuesi duhet të dëshmojë që ekipi i testimit të penetrimit posedon ekspertizë në fusha të ndryshme si: web</p>

	<p>applications, network infrastructure, dhe social Engineering</p> <p>Per lot 2: Stafit profesional i përfshirë në vlerësim duhet të ketë realizuar së paku 3 vlerësime kibernetike gjatë 3 viteve të fundit dhe duhet të posedojë njohuri të mjaftueshme mbi sigurinë SWIFT, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimin e Kornizës së Kontrollit të Sigurisë së SWIFT (Swift Security Control Framework). • Kontrollin e detajuar të masave të detyrueshme dhe këshilluese të sigurisë. <p>Evidenca 10: CV të detajuar të secilit anëtar të ekipit dhe certifikime përkatëse.</p> <p>Kërkesa 11: (Vetem për Lot 1): Kontratat valide të stafit-Anëtarët e ekipit të ofertuesit duhet të kenë kontrata valide me kompaninë ofertuese për të paktën 6 muajt e fundit</p> <p>Evidenca 11: Kopje të kontratave të punës për secilin anëtar të stafit që përfshihet në projekt.</p> <p>Kërkesa 12: (Vetem për Lot 2): Ofertuesi duhet të jetë i listuar në njërin nga direktorët e krijuar nga SWIFT për ofruesit e shërbimeve të vlerësimit:</p> <p>"Directory of CSP Assessment Providers" ose</p> <p>"Directory of Swift CSP Certified Assessors" (pavarësisht statusit të listimit).</p> <p>Evidenca 12: Dëshmi zyrtare që vërteton listimin e operatorit ekonomik në direktorët përkatës të SWIFT.</p>
--	--

V PROCEDURA:

V.1 Lloji i procedurës: “Procedurë e hapur”, sipas *Nenit 10 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)*.

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS:

“Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të ulët”, në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK.

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE PËR OFERTUESIT

<p>Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 01.08.2025, ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.</p>
<p>Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 01.08.2025, ora 14:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.</p>
<p>Afati i fundit dhe vendi i dorëzimit të ofertave, data: 05.08.2025, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.</p>
<p>Takimi për hapjen e ofertave, data: 05.08.2025, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.</p>
<p>Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): Lotin 1: 2,000.00 € (dy/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite, (dorëzohet me ofertë). Lotin 2: 1,000.00 € (një/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite, (dorëzohet me ofertë).</p>
<p>Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.</p>
<p>Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertës.</p>
<p>Dokumentet me pagesë: Jo</p>

VIII. ANKESAT

<p>Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.</p>
--

IX. ADRESA

Rr. "Garibaldi" 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763